

NËNA TEREZË

Për Gonxhe Bojaxhiu – Nënë Terezë - deri me tani janë shkruar shumë libëra, poezi, prozë, anë e mbarë botës, janë bërë me qindëra reportazhe, programe dokumentar si dhe intervista nga gazetar të shumtë, mirëpo pranë të gjithave prapë kjo figurë, ky personalitet tërheq kureshtarët e jetës dhe veprës së saj, tërheq besimtar e jo besimtar, të pasur e të varfër, të moshuar e të rinjë...pra çdo njeri vullnetmirë dhe human, secilin që don Zotin dhe krijesat e tij, pra vet njeriun. Për ta kuptuar sa më mirë dhe drejtë jetën dhe punën e Nënës së botës, nisemi me lutjen /poezinë/ të cilën e shkroi vet ajo e që i drejtohet njerzimit;

Jeta është mundësi, përfito nga ajo!
Jeta është e bukur,adhuroje!
Jeta është ëndërr, jetoje!
Jeta është sfide, përballu me te!
Jeta është lojë, luaje!
Jeta është detyrë, plotesoje!
Jeta është e shtrenjtë, vlerësoje!
Jeta është pasuri, ruaje!
Jeta është dashuri, shijoje!
Jeta është mister, zbuloje!
Jeta është dhimbje, sfidoje!
Jeta është këngë, këndoje!
Jeta është tragjedi, shmangiu!
Jeta është fat, përfito!
Jeta është aventurë, kujdes!
Jeta është shumë e çmuar, duaje!
Jeta është luftë, mësohu dhe me te!
Jeta është jetë, lufto për të..."

Jeta e së lumes Nënë Terezë, me fjalë të shkurtëra këndvështruar nga Papa Gjon Pali II, i cili shpalli lumturimin e bamirëses shqiptare Gonxhe Bojaxhiu-t. Ai ndër të tjera, thot; **„jeta dhe historia e një vajze shqiptare është; përpjekja për të zgjidhë hallet dhe problemet e gjithë botës**

Kurse Nëna Terezë për vetjen e saj thot; **„Me gjak jam shqiptare, me nënshtetësi indiane, për sa i përket besimit, jam murgeshë katolike, kurse sipas thirrjes, i përkas botës. Por zemra ime i përket plotësishtë Zemrës së Krishtit!“**. Nënë Terezë, një gruajë me rrudha në fëtyrë, e një shtati të shkurtër dhe të ligishtë por grua e një besimi të palëkundur dhe shkëmbor në Jezu Krishtin, iu besua misioni të kumtoj e bartë kujdesinë, mirësinë dhe dashurinë e etur për Jezusin mbarë njerëzimit, veçanërisht të shtypurve, të përndjekurve, të braktisurve e në veçanti të varfërve ndër më të varfër. **“Hyji vazhdon ta dojë botën dhe pikërishtë për këtë na dërgon ty, mua, për t’u shprehur e shpallur të varfërve dashurinë dhe mëshirën e Tij”**. Dëshira e saj e vetme ishte: **“Të shuaj etjen e dashurisë së Tij për shpirtrat njerëzore”**.

Biografia e së Lumës Nënë Terezë - Gonxhe Bojaxhiu-t!

Kjo lajmëtare e ndritur e dashurisë së Zotit, u lind më 26 gusht 1910, në Shkup /Maqedoni/, qytet i lashtë shqiptar i vendosur në udhëkryq të historisë së Ballkanit. Nëna Terezë ishte fëmija më i vogël, i treti /*Lazëri, Agnjeza dhe Gonxha-Nëna Terezë*/ sa kishin prindërit Kolë dhe Drane Bojaxhiu l. Bernaj. E pagëzuan me emrin Gonxhe, dhe ajo qyshë si fëmijë ishte e dashur dhe përkrahur nga prindërit bëmirës, human dhe në zë të mirë. Kungimin e parë e mori në moshën pesë vjeçare e gjysmë, gjersa sakramentin e krezmimit e pranoi në nëntor të vitit 1916.

Që ditën e Kungimit të parë, ajo ndjeu në zemër e saj fëmijërore një dashuri të flakët dhe të thellë për shpirtërat njerëzor, sidomos për të varfër dhe të braktisur.. Me vdekjen e papritur dhe të hershme të babait poliglot, tregtar i suksesshëm dhe politikan patriot shqiptar /*ishte i helmuar nga regjimi i atëhershëm i mbretërisë serbo-kroato-slloven*/ në sa Gonxhja nuk i kishte mbushur ende 8 vjetët, për familjen Bojaxhiu filluan shqetësimet, mundimet dhe vështirësitë ekonomiko-sociale. Nënë Lokja Dranë /kështu e quante nga dashuria Nëna Terezë/ ishte një grua burrneshë, edhe pse me mund të madh, ajo i rriti dhe edukoi fëmijët në dashuri e humanizëm si dhe përshtpirtëri, kështu ndikoi shumë në karakterin dhe rrugën e tyre jetësore si dhe në jetën dhe rrugën e Gonxhes së re. Më pas formimi fetar i Gonxhes u thellua në famullinë e Zembrës së Krishtit, nën drejtimin e jezuitëve, në sa merrte pjesë aktivishtë në të gjitha veprimtaritë.

a/ Vendosi të bëhet misionare e Krishtit!

Qysh nga mosha rinore ajo përjetoi dashurinë dhe qe mësuar të dojë të afërmit e saj, ta duaj njeriun vëlla e motër e sidomos të varfërit, të sëmuarit, të braktisurit, ata që vuajnë... Këtë mësim e morri nga Nëna Dranë e në gjirin fmailjar. Gjithnjë aktive në Kishën e Zembrës së Krishtit në Shkup, dhe e përkrahur, e pjekur shpirtërisht nga meshtarët, sidomos jezuit që shërbenin aty, vajëza e re me emërin Gonxhe e cila për çdo vit së bashku me familje shtegëtonte për festën e Zonjës së Madhe /Të Ngriturit e Zonjës në qiell/, në Letnicë /të Vitisë-Kosovë/ pas një shtegtimi ajo në moshën 18-vjeçare, e shtyrë nga dëshira e madhe për t'u bërë misionare, për ti shërby Zotit dhe njeriut, vendosë para truporës së Zonjë Cërnagore; *Do bëhem motër nderi, misionare!* Kështu, vendimi i saj ishte definitiv dhe qysh në shtator të vitit 1928, Gonxhja i thot lamtumirë shtëpisë atërore, vendlindjës, për të shkuar së pari në Zagreb /Kroaci/ e nga aty për në Irlandë, ku hynë në Institutin /rregullin/ e së Lumës Zojë, e që njihet ndryshe me emërin „Motrat e Loretos“. Këtu merr emërin motër Mari Tereza, në nderë të Shën Terezës së Krishtit Fëmijë. /Ndërrimi i emërit në rreguj është shenjë simbolike që tregon ndërrimin e jetës në një jetë të re/. Këtu shkoi me qëllim që të ketë mundësi së shkuarjës në misioni. Pikërishtë edhe ndodhi kështu, ajo pas një përgaditjeje, në dhjetor u nis për në Indi. Në Kalkutë arriti më 6 janar të vitit 1929. Pasi bëri kushtet e përkohshme, në maj të vitit 1931, motër Tereza u dërgua në bashkësinë e Loretos, në Entali, ku dha mësim në shkollën St.Mary për vajza.

Më 24 maj 1937, motër Tereza jep betimin e kushteve të përjetshme, duke u bërë, siç tha ajo vetë: *“Vashë e Jezusit” për “amshim”*.

Vazhdoi të jap mësim në St. Mary, kurse më 1944 u emërua edhe drejtoreshë e kësaj shkolle. Motra që ia kishte kushtuar jetën lutjes, meditimit, punës, fëmijve /nxënësve/ si dhe simotrave të saja, Nënë Terezë, në Loreto jetoi e lumtur për plotë njëzet vite me radhë... E njohur për zemërgjerësi, humanizëm, për ndihmë njeriut vëlla e motër, për bujari, guxim, aftësi të posaçme në kryerjen e punëve më të rënda dhe për talent të natyrshëm organizativ, ajo gjitha këto i jetoi në përkushtim të madh ndaj Jezusit. Nga e gjithë angazhimi i saj, shkaku i afërsisë, bamirësisë, gadishmërisë së përhershme për ti ndihmuar e shërybyer të tjerëve, nga gjithë ata

që përjetuan dashurinë e saj e me këtë të Jezu Krishtit, fillojnë ta thrrasin „Nënë“, **Nënë Tereza**, sepse vërtetë për të gjithë kujdesej si nënë, pa dallim kombëtar, fetar, racor etj. Mirëpo, atë gjithnjë e mundonte dhe brente diç në shpirtin dhe zemrën e saj. Pamjet, mjerimi, sëmundjet e ndryshme e njerëzit e braktisur nuk e lenin të qetë qenien e saj.

b/ Në shërbim të varfërve, sëmuarve, braktisurve...

Më 10 dhjetor 1946, gjatë një udhëtimi me tren që kishte nga Kalkuta për Darjeeling, ku kryente ushtrimet shpirtërore vjetore, Nënë Tereza ndjeu *“frymëzimin”* e ri, *“thirrjen brenda thirrjes”*. Që nga kjo ditë ndjenja për dashuri ndaj të braktisurve dhe të varfërve ndër më të varfër e kaploi zemrën dhe shpirtin e saj, çka ndodhi në qenien e saj, ende shumkush pyet çka ndodhi me te?!, Mirëpo ajo dinte dhe njihte në momente të caktuar planin dhe vullnetin e Zotit, ndjente zërin i cili e thërriste dhe shpiente drejtë rrugëve që shpjen kah Jezu Krishti. Ditëve, javëve e muajve në vijimi ajo nisi të dëgjoj gjithnjë e më shumë një zë të mbrendshëm që i fliste shpirtit të saj e që nuk e linte të qetë e dukej se kishte edhe vegime. Krishti i zbulonte kështu dëshirën e zemrës së Tij për kujdes ndaj; *“njerëzve, që duke u flijuar nga dashuria për dashurinë”*, e që do të rrezatoj e shpërndajë dashurinë e Tij ndër shpirtira”. *“Eja, të jesh drita ime”* - iu lut - *“nuk mund të shkoj vetëm”*. Jezusi i tregoi sa vuante, duke ia bërë me dije për moskujdesin ndaj të varfërve. Së bashku me ta vuante edhe vet Ai, sidomos për atë që këta njerëz të mjerë nuk e njohin ende dashurinë e zjarrët që kishte për ta. Jezusi nga Nënë Terezë kërkoi të themeloj ajo një bashkësi rregulltare, që do t’i kushtoheshin shërbimit ndaj të varfërve ndër më të varfër!

Kaluan rreth dy vjet pritjeje, para se Nënë Terezë të merrte lejen për fillimin e misionit të saj të ri. Dhe së fundi Zoti ia plotësoi dëshirën, kështu me 17 gusht 1948, ajo veshi për herë të parë petkun, sarin e bardhë, /veshje e shtresës më të ulët të popullatës në Indi/ me anët blu dhe la pas shpine kangjellat e kuvendit të Loretos, të cilin e donte aq shumë, për të hyrë në botën e të varfërve.

Pas një kursi të shkurtër pranë „Motrave Mjete Misionare“ në Patna, Nënë Tereza u kthye rishtas në Kalkutë, ku gjeti një strehë të përkohshme pranë „Motrave të Vogla të të Varfërve“. Më 21 dhjetor shkeli për herë të parë, kjo „dritë rrezeje ngushllimi dhe kujdesi“ në lagjet e të varfërve, të Kalkutës, në botën e mjerimit dhe tmerrit, vizitoi familje, ua pastroi plagët disa fëmijëve, e morri dhe u kujdes për një plak që dergjej e qelbej nga plagët në rrugë... i ndihmoi një gruaje që po vdiste nga uria e nga tuberkulozi /TBC/. Nëna Terezë çdo ditë të saj e fillonte herët në mëngjes me Jezusin në Eukaristi; pastaj, me rruzare në duar, dilte për t’i gjetur dhe për t’u shërbyer atyre që janë: “të braktisur, të urrejtur, të pastrehë, në dhimbje e plagë”. Duke parë kujdesin e në engjëlleshe, dalngadal e muaj më vonë, ajo filloi të gjejë përkrahje dhe kështu filluan ti bashkohen punës dhe jetës së saj, njëra pas tjetrës, e këto ishin vajëzat, ish-nxënëset e saja. Kështu filloi të krijohet shtëpia, ngushllimi i të pastrehurve dhe vet rregulli të cilën në mënyrë të mrekullueshme e themeloi Nëna e jonë Tereze me emërin „Misionaret e Bëmirësisë“.

Më 7 tetor të vitit 1950, Kryedioqeza e Kalkutës e njohi dhe pranoi edhe zyrtarisht Kongregatën e re të Misionareve të Bamirësisë. Tashmë edhe numëri i motrave ishte i mirë dhe gjithnjë në rritje pët tu shërbyer të varfërve. Në muajt e parë të vitit 1960, Nënë Tereza filloi t’i dërgonte motrat e saj në të katër anët e Indisë. E Drejta Papnore, lëshuar Kongregatës nga Papa Pali VI në shkurt të 1965-ës, i dha zemër të hapte një shtëpi misionare në Venezuelë. Menjëherë pas saj u themeluan shtëpi të tjera në Romë e në Tanzani dhe, pak më vonë, në të gjitha kontinentet. Duke filluar nga viti 1980, deri më 1990, Nënë Tereza hapi shtëpi misioni pothuajse në të gjitha vendet komuniste, duke përfshirë edhe ish-Bashkimin Sovjetik, Shqipërinë dhe Kubën.

c/ Themelimet e Nënë Terezë!

Për t'iu përgjigjur sa më mirë si nevojave fizike, ashtu dhe atyre shpirtërore të të varfërve, Nënë Tereza më 1963 themeloi „Vëllezërit Misionarë të Bamirësisë“;

Vitin 1976, „degën kundruese të motrave“;

Vitin 1979, „Vëllezërit kundrues“ dhe më 1984; „Etërit Misionarë të Bamirësisë“.

Gjithsesi, frymëzimi i saj nuk u kufizua vetëm në njerëzit e thirrur për jetë rregulltare. Organizoi „Bashkëpunëtorët e Nënë Terezës“ dhe „Bashkëpunëtorët e Sëmurë dhe të Munduar“, njerëz të feve e kombësive të ndryshme, me të cilët u bë NJË në lutje, thjeshtësi, flijim dhe në apostullimin e saj që shprehej me vepra të përvuajtura bamirësie. Kjo frymë e shtyu të themelonte më pas „Misionarët Shekullarë të Bamirësisë“. Duke iu përgjigjur kërkesës së shumë meshtarëve, më 1991 Nënë Tereza themeloi edhe; „Lëvizjen e Korpit të Krishtit për Meshtarë“, si *“rrugë e vogël që i shpie në shenjtërim”* ata, të cilët ishin një mendje me karizmën dhe me shpirtin e saj.

Për gjithë këtë punë vetmohuese, Zoti e shpërbley me thirrje të shumta, por nuk ngelën as dekoratat e shpërblimet tjera, që kuptohet gjithat i shkriu në shërbim të njeriut nevojtar.

d/ Çmimet për veprën e saj bamirëse

Gjatë këtyre viteve, ndërsa misioni i saj përhapej me të shpejtë, bota filloi t'ia ngulte sytë Nënë Terezës dhe veprës që ajo kishte nisur. Meritoi shumë çmime për veprën e saj, duke filluar nga Çmimi indian Padmashri, në vitin 1962, për të vijuar me çmimin më të madh për humanizëm, çmimin; ***Nobel për Paqen, më 1979***, ndërsa mjetet e komunikimit filluan t'i ndiqnin veprimtaritë e saj me interes gjithnjë e më të madh. Si çmimet, ashtu edhe gjithçka që e vinte në qendër të vëmendjes, i pranoi *“për lavdinë e Zotit e në emër të të varfërve”*.

Gjithë jeta dhe vepra e Nënë Terezës është dëshmi e gëzimit që buron nga dashuria, e madhështisë dhe e dinjitetit të çdo njeriu, e vlerës së gjërave të vogla të bëra me besnikëri e me dashuri, e sidomos, e vlerës së pakrahasueshme të miqësisë me Zotin. Por duhet theksuar edhe një virtut tjetër heroik i kësaj gruaje të madhe, i cili u bë i njohur vetëm pas vdekjes së saj. E fshehur nga sytë e të gjithëve, e fshehur deri nga ata që i qëndruan më pranë, jeta e saj e brendshme u vu në provë: pati përshtypjen e dhembshme e të vazhdueshme se ishte ndarë nga Zoti, madje se ai e kishte braktisur, ndërsa në shpirt i rritej gjithnjë e më tepër dëshira për ta pasur pranë. Atë që po provonte e quajti *“errësirë”*. *“Nata e dhembshme”* e shpirtit të saj, e cila nisi në kohën kur sapo kishte filluar apostullimin mes të varfërve e që vijoi gjatë gjithë jetës, e çoi Nënë Terezën në një bashkim edhe më të thellë me Zotin. Përmes errësirës, mori pjesë mistikisht në etjen e Krishtit, në dëshirën e tij të dhembshme e të zjarrtë për dashuri, duke u njësuar me mjerimin e të varfërve.

Gjatë viteve të fundit të jetës, pa marrë parasysh problemet e shumta e serioze shëndetësore, Nënë Tereza vijoi t'i printe Kongregatës së saj dhe t'u përgjigjej nevojave të të varfërve e të Kishës.

Në vitin 1997, Nënë Tereza kishte 4000 motra, të pranishme në 610 shtëpi misionare, të përhapura në 123 vende të Botës. Në mars të vitit 1997, bekoj Eproren e re të Përgjithshme, të sapozgjedhur, të Misionareve të Bamirësisë e bëri edhe një udhëtim jashtë shteti. Si pati takuar Papën Gjon Pali II për të mbramen herë, u rikthye në Kalkutë, ku kaloi javët e fundit të jetës, duke pritur vizitorë e duke u dhënë këshilla simotrave.

Më 5 shtator 1997, jeta tokësore e Nënë Terezës arriti cakun e fundit. Qeveria indiane e nderoi me funeralin e Shtetit, në përfundim të të cilit trupi i saj u varros në Shtëpinë - Amë të Misionareve të Bamirësisë. Shumë shpejt varri i saj u bë cak shtegtimi e lutjeje për njerëz të

besimeve të ndryshme, për të varfër e për të pasur, pa kurrfarë dallimi. Nënë Tereza na lë testamentin e fesë së patundur, të shpresës së pamposhtur e të bamirësisë së jashtzakonshme. Duke iu përgjigjur thirrjes së Jezusit “Eja, të jesh drita ime!”, u bë Misionare e bamirësisë, “Nënë e të varfërve”, simbol i mëshirës për mbarë botën e dëshmitare e gjallë e dashurisë së etshme të Zotit.

Më pak se dy vjet pas vdekjes, për shkak të përhapjes së zërit të shenjtërisë dhe hireve të nxjerra me ndërmjetësinë e saj, Papa Gjon Pali II lejoi të hapej çështja e kanonizimit. Më 20 dhjetor 2002 miratoi dekretin mbi virtytet heroike dhe mrekullitë e bëra me ndërmjetësinë e saj. Për gjitha veprat e mrekullitë e saja gjatë jetës tokësore dhe tashmë ndërmjetësimin e saj nga qielli e mrekullitë e bëra, Kisha Katolike ate e ka shpallur të Lume, gjersa presim dhe lusim Zotin që sa më parë ta shpallë edhe Shenjtëreshë. Kurse neve na mbetët ta lusim gjithnjë bijën tonë shqiptare Nënë Terezë për gjitha nevojat tona të përditshme.

Ky vit është shpallur në shumë shtete si dhe në shtetin Shqipëri, dhe në Shtetin Kosovë, VITI I NËNË TEREZA /kujtojmë 100 vjetorin e lindjes së saj/ .

Këtë paraqitje e përfundoj me dëshminë e Nënës Terezë e cila kahdo shkoi e kudo u paraqit, tha;

*„Unë gjithmonë e kam në
zemër popullin tëm shqiptar.
Shum luti zotin që pasja
e tij të vij në zemrat tona,
në gjitha familjet tona, në gjith
botën. Lutem shumë për fukarat
e mij – dhe për mua dhe motrat
e mija. Unë lutem për juve“.*

Mc(Mission of Charity)
Tereza Bojaxhiu

Leonard Sopi
Graz, Austri '2010